



## American School of Kosova

Together educating the leaders of tomorrow for a better future.

### Sillni pajisjen tuaj “Bring Your Own Device” (BYOD)

Inkurajon bashkëpunim plot respekt në fushën e teknologjisë



American School of Kosova është e përkushtuar që të punojë me nxënësit dhe anëtarët e stafit që të krijojë një ambient të mësimi të shekullit 21. Për të mbështetur këtë qëllim, nxënësit dhe anëtarët e stafit mund të kyqen në rrjetin e internetit me pajisjet e tyre personale (laptopë, tableta, etj). Anëtarët e stafit do të mund të përdorin telefonat e tyre gjatë ditës së shkollës mirëpo nxënësit duhet të paraqesin telefonin e tyre tek mësuesi në fillim të secilës orë. ASK ka implementuar një proces të vetë-regjistrimit që drejton pajisjet tek një rrjet i caktuar gjatë procesit të regjistrimit. Pasi që të kyqen, nxënësit do të kenë qasje në burimet e ASK-së prej pajisjes së tyre personale. Nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë për të regjistruar pajisjen e tyre duhet të takohen me ekipin që ju ndihmon me teknologji.

Me aprovimin e mësuesit të lëndës, nxënësit mund të përdorin pajisjen e tyre për tu kyçur me internet dhe të bashkëpunojnë me nxënësit e tjerë. Duke i lejuar nxënësit të kyqen me internet në kampus, shpresojmë që të rrisim qasjen në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë teknologjinë për të cilën kanë nevojë që të mësojnë në mënyra të reja dhe të zhvillojnë një nivel më të lartë të të menduarit.

Pjesëmarrja e nxënësve në programin BYOD udhëheqet nga të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve të paraqitura në doracakun e nxënësve të ASK-së. Nga prindërit dhe nxënësit kërkohet që të lexojnë dhe të pranojnë rregullat e përdorimit për qasjen e nxënësve me internet të cekura në doracakun e nxënësve të ASK-së. Autorizimi për përdorimin e BYOD njihet me nënshkrimin e faqes së fundit në këtë dokument nga prindi apo kujdestari.

#### Gjatë ditës së shkollës

Nxënësit do të përdorin pajisjet e tyre të regjistruara për të kryer aktivitetet e klasës, detyrat e shtëpisë, të bashkëpunojnë në kohë të caktuar, të kryejnë projektet hulumtuese, të kyqen në webfaqe me përmbajtje të ndërlidhur me planprogram, t'i përcjellin detyrat e klasës dhe të ruajnë të dhënat e në ditar dhe aktivitetet e tjera udhëzuese të aprovuara.



## American School of Kosova

Together educating the leaders of tomorrow for a better future.

Nxënësit duhet të sjellin pajisjet e tyre personale për përdorim të veçantë vetëm në atë klasë ku i ka lejuar mësuesi. Pajisjet nuk lejohen në hapësirat e tjera të shkollës (korridore, kafiteri, dhomat e dollapeve, banjot, shkallat, etj.) përveç nëse është e lejuar.

### Siguria, vjedhja apo dëmtimi

Pajisjet janë përgjegjësi vetëm e nxënësit. ASK nuk merr asnjë përgjegjësi për ruajtjen dhe sigurinë e pajisjeve. Nxënësit janë përgjegjës për sigurinë e pajisjes. Mësuesit apo anëtarët e tjerë të stafit nuk do t'i mbajnë apo ruajnë pajisjet. Pjestarët e departamentit të teknologjisë në shkollë apo mësuesit, nuk do të mbështesin, riparojnë apo rregullojnë pajisjet e nxënësve.

### Rregullat për mbushjen me bateri të pajisjeve personale gjatë ditës së shkollës

Rekomandohet që të vini në shkollë me pajisje të mbushura me bateri. Nxënësit duhet ta kenë parasysh se shkolla nuk është përgjegjëse për t'ua mundësuar nxënësve rrymën e nevojshme për të mbushur pajisjet e tyre gjatë orarit të shkollës.

### Aplikacionet dhe Softuerët që përdoren në klasë

ASK nuk ofron dhe as nuk kërkon aplikacione apo softuerë të veçantë për pajisjet personale. Mësimet në klasë do të formulohen në mënyrë të përshtatshme që të gjithë nxënësit të kenë qasje në to. Atëherë kur është e mundur, nxënësi mund të zgjedh të kryejë detyrat e tij në pajisjen personale. Shfletuesi i internetit i krijuar për pajisjet personale mund të përdoret për tu futur në aplikacionet edukative në llogarinë e Google të ASK-së.

### Në rast se dëmtohet një pajisje në shkollë

Nxënësi nuk do ta përdorë atë pajisje dhe në fund të ditës do ta marr me vete në shtëpi ku nxënësi dhe prindi mund ta rregullojnë pajisjen. ASK ka burime të limituara dhe nuk mund të ofrojë mbështetje të plotë për pajisjet e ndryshme që lejohen për këtë program.



## American School of Kosova

Together educating the leaders of tomorrow for a better future.

### Filtrimi i përmbajtjeve në internet

Për të lehtësuar udhëzimet dhe për të praktikuar sigurinë në internet, rrjeti i internetit të ASK është i mbrojtur me një filtrues të përmbajtjeve në internet. Planet e internetit të celularëve nuk e përdorin rrjetin e internetit të ASK-së prandaj nuk e përdorin as filtruesin e përmbajtjeve të internetit të ASK-së. Gjatë kohës kur janë në ASK, nxënësit duhet të përdorin vetëm rrjetin e internetit të ASK-së në pajisjet e tyre BYOD.

### Monitorimi i aktivitetit në pajisjet BYOD

Sistemi i rrjetit të internetit BYOD, interneti i ASK-së, përdoret vetëm për regjistrimin e pajisjes dhe jo menaxhimin e pajisjes, prandaj ASK nuk mund të monitorojë aktivitetet në pajisjet BYOD. Qëllimi i sistemit është që të mundësojë një mekanizëm të thjeshtë për të regjistruar pajisjet BYOD dhe për t'ua mundësuar nxënësve dhe punëtorëve përdorimin e rrjetit të internetit të ASK-së në pajisjet e tyre.

Gjatë procesit të regjistrimit, informatat si IP Adresa dhe Adresa MAC mblidhen dhe regjistrohen. Këto informacione përdoren për të kërkuar ndonjë pajisje e cila humb apo merr pjesë në ndonjë aktivitet të papërshtatshëm që shkel rregullat e përdorimit (Acceptable Use Policy - AUP). Qëllimi i ASK-së nuk është që vazhdimisht të menaxhojë, monitorojë apo të qaset në pajisjet BYOD. Në rastet kur mund të jenë shkelur rregullat e përdorimit, ASK ka të drejtë që të hulumtojë të gjitha pajisjet dhe aktivitetet në rrjetin e internetit të ASK-së duke përfshirë pajisjet BYOD për të përcaktuar nëse është kryer ndonjë shkelje.

### Blerja e pajisjes për fëmijën tuaj

Pajisjet personale janë shtesë për pajisjet të cilat tashmë përdoren në klasë. BYOD është program opsional dhe nuk kërkohet nga prindërit që të blejnë një pajisje për fëmijën e tyre. Edhe pse ASK nuk i rekomandon disa produkte të veçanta të teknologjisë, ju inkurajojmë të kontaktoni direkt partnerët e autorizuar për detajet lidhur me modelin dhe specifikat teknike.



## American School of Kosova

together educating the leaders of tomorrow for a better future.

Këshillat:

### **Nxënësit duhet të:**

Lexojnë dhe pranojnë rregullat e përdorimit të internet për nxënës në doracakun e nxënësve të ASK-së.

13. Mbushin me bateri pajisjen e tyre në mbrëmje para se të vijnë në shkollë.
14. Përdorin vetëm rrjetin e internetit të ASK-së gjatë kohës që janë në shkollë.
15. Mbajnë pajisjen e tyre afër vetës. Nuk duhet t'ua huazojnë askujt.
16. Marrin lejen e mësuesit para se të përdorin pajisjen e tyre personale.
17. Dinë se cili është qëllimi i secilit aplikacion. Mësuesit nuk do të sygjerojnë asnjë aplikacion.
18. Marrin lejen nga prindërit para se të instalojnë një aplikacion të ri. Shkolla nuk kërkon ndonjë aplikacion të veçantë.
19. Përdorin pajisjen e tyre VETËM për qëllimet brenda klasës. Nuk lejohen rrjetet sociale, etj.
20. Respektojnë hapësirat ku nuk lejohet përdorimi i pajisjeve (banjo, dhomat me dollapë, etj.).
21. Rregullojnë vetë pajisjen e tyre, duke kërkuar ndihmë nga prindi jo mësuesi i tyre.
22. Mbajnë të sigurt pajisjen e tyre duke e vendosur në dollap me çelës apo metoda tjera të aprovuara.
23. Mbajnë në mend se ky është një PRIVILEGJ i cili mund të hiqet në çdo moment.